



Qeveria e Republikës së Maqedonisë së Veriut
Agjencia për mbështetje financiare në bujqësi dhe zhvillimin rural

Në bazë të nenit 9 paragrafi 1 pika b nga Ligji për ratifikimin e marrëveshjes sektoriale mes Qeverisë së Republikës së Maqedonisë dhe Komisionit Evropian për vendosjen e dispozitave për menaxhimin dhe zbatimin e ndihmës financiare të Unionit për Republikën e Maqedonisë sipas Instrumentit për ndihmë në sektorin e politikës për "Bujqësi dhe zhvillim rural" (IPARD) (Gazetar zyrtare e RM nr. 38/2016), në bazë të pjesës II masë në Diversifikimin e fermave dhe zhvillimin e biznesit pika 11 nga Programi për përdorimin e mjeteve nga Instrumenti për ndihmë për zhvillim rural në Unionin Evropian (IPARD) për periudhën 2014-2020 (Gazeta zyrtare e RM nr. 177/2016), dhe në bazë të nenit 6 nga dekreti për mënyrën dhe procedurën e shfrytëzimit të mbështetjes financiare për masat për zhvillim rural të financuara nga IPARD 2014-2020 (Gazeta zyrtare e RM nr. 64/2016) dhe (Gazeta Zyrtare e RMV" nr. 58/2019)

Agjencia për përkrahje financiare në bujqësi dhe zhvillim rural
më 08 korrik 2021 publikon

THIRRJE PUBLIKE nr. 01/2021

për dorëzimin e kërkesave për shfrytëzimin e mjeteve nga
IPARD Programi 2014-2020

1. Agjencia për mbështetje financiare në bujqësi dhe zhvillimin rural (në tekstin e mëtejshëm: Agjencia) si institucion përgjegjës dhe organ kontraktues për zbatimin e Instrumentit për ndihmë qasëse për zhvillim rural të BE (IPARD) ju bën thirrje të gjithë personave fizik dhe juridik të Republikës së Maqedonisë Veriut të dorëzojnë kërkesë për shfrytëzimin e mjeteve nga IPARD programi 2014-2020 për masat në vijim:

1. Diversifikimi i fermave dhe zhvillimi i bizneseve.

2. Mbështetja financiare për këtë Thirrje publike është e përbërë nga 75% mjete të siguruara nga Instrumenti për ndihmë qasëse për zhvillim rural të Bashkimit Evropian (IPARD) në përputhje me Marrëveshjen Financiare 2014-2020 dhe 25% mjete të siguruara nga Buxheti i Republikës së Maqedonisë së Veriut.

3. **Mjete financiare sipas kërkesës individuale** shpërndahen si mbështetje financiare e pakthyeshme (grant) në shumë prej:

3.1. 65% nga vlera e shpenzimeve të përgjithshme të pranueshme të investimeve për masën "Diversifikimi i fermave dhe zhvillimi i bizneseve".

4. Afati i fundit për dorëzimin e kërkesave është më 22 gusht 2021

5. Tërheqje të formularëve dhe udhëzime:

Formularët e nevojshëm për "Kërkesën për shfrytëzimin e mjeteve financiare nga IPARD Programi 2014-2020" si dhe "Udhëzimi për shfrytëzimin e mjeteve financiare nga IPARD Programi 2014-2020" në të cilët janë të përmbytur të gjitha informatat për kriteret, kushtet për pranueshmëri të projekteve dhe kushtet për financim dhe informatat tjera të cilët janë të nevojshme për përgatitjen e kërkesës për shfrytëzimin e mjeteve nga IPARD Programi 2014-2020, Udhëzues për përgatitjen e Planit Afarist/Propozim Projektit Teknik, Udhëzimet për dhënie e dokumentacionit të nevojshëm nga institucionet kompetente dhe informacione të tjera të dobishme në versionin elektronik mund të merren nga ueb-adresa e Agjencisë: www.ipardpa.gov.mk.

Formularët e shtypura sipas kërkesës për shfrytëzim të mjeteve nga IPARD Programi 2014-2020 dhe Udhëzimi për shfrytëzuesit e mjeteve nga IPARD Programi 2014-2020 mund të merren drejtpërdrejtë në Agjenci në adresë: **Agjencia për mbështetje financiare në bujqësi dhe zhvillim rural, bul. 3-ta Makedonska Brigada nr. 20, (ndërtesa Makedonija Tabak bllok C), 1000 Shkup** dhe në qendrat më të përafërta rajonale ose njësitë e punës në **Agjencinë për nxitje të zhvillimit në bujqësi** çdo ditë pune **prej ora 8:30 deri në ora 16:30**. (Lista e qendrave rajonale ose njësisive rajonale të Agjencisë për nxitje të zhvillimit në bujqësi me të dhënat për kontakt është publikuar në ueb adresën www.ipardpa.gov.mk).

6. Mënyra e dorëzimit të kërkesës:

Kërkuesi duhet të plotëson dhe të dorëzon Kërkesë për shfrytëzimin e mjeteve nga IPARD Programi 2014-2020 për masën 7 – Diversifikimi i firmave dhe zhvillimi i bizneseve dhe dokumentacioni i tërësishëm siç është theksuar në këtë Shpallje publike.

Kërkesa e plotësuar për shfrytëzimin e mjeteve nga IPARD Programi 2014-2020 dhe dokumentacioni i përgjithshëm i nevojshëm dorëzohet në zarf të mbyllur me shenjë në pjesën e përparme të zarfit në këndin e majtë të epërme "MOS E HAP" për Thirrjen Publike IPARD numër 01/2021 dhe shënimin e masës për të cilën dërgohet kërkesa. Kërkesa mund të dërgohet me postë si dërgesë e rekomanduar ose personalisht në sportelin e Agjencisë.

Pas përfundimit të investimit, kërkuesi obligohet që të parashtrojë deri te Agjencia kërkesë për pagesë në afatin e caktuar në Marrëveshjen për shfrytëzim të mjeteve.

Kërkesa për pagesë është e kërkesës e unifikuar të cilin shfrytëzuesit përfundimtar e marrin gjatë nënshkrimit të marrëveshjes për mbështetje financiare. Kërkesat për pagesë gjithashtu do të mund të jenë të qasshme për marrje në hapësirat e Agjencisë dhe në ueb faqen www.ipardpa.gov.mk

Vërejtje:

Për shkak të përfundimit të periudhës programore të IPARD 2014-2020, afati përfundimtar për realizimin e investimeve është 31.05.2023, ndërsa afati përfundimtar për parashttrimin e kërkesës për pagesë 30.06.2023.

Vërejtje: Për shkak kryerjes së kontrollit në teren nga ana e Agjencisë duhet që kërkuesi të ketë në vetvete kopje nga dokumentacioni i përgjithshëm i dorëzuar deri te Agjencia.

Informata më të hollësishme në kontakt tel. (02) 3097-460 ose në e-mail adresën: ipardpa.info@ipardpa.gov.mk ose në ueb-faqen: www.ipardpa.gov.mk.